

VENDIM
Nr.111, datë 9.3.2007

PËR KRIJIMIN E GRUPEVE TË PUNËS PËR IDENTIFIKIMIN DHE DHËNIEN ME KONCESION

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e grupeve të punës për identifikimin dhe dhënien me koncesion, të cilat do të funksionojnë deri në krijimin e Njësisë së Trajtimit të Koncesioneve, por jo më shumë se gjashtë muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

2. Objekti i veprimtarisë dhe përbërja e çdo grupi pune përcaktohen me urdhër të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

3. Anëtarët, në përbërje të grupeve të punës, shpërblehen në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2007, miratuar për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

5. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 mars 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha